



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

14 organizata të grave marrin grante nga Raundi i tetë i Fondit të Grave të Kosovës

E enjte, 19 nëntor 2015, ora 10:00
Hotel Prishtina, Prishtinë

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), bashkë me Austrian Development Agency (ADA) dhe Zyren e Bashkimit Evropian në Kosovë, do të mbajnë konferencë për shtyp me 19 nëntor 2015 (e enjte), në ora 10:00 në Hotel Prishtina, në Prishtinë.

Në këtë konferencë do të bëhet nënshkrimi i kontratave me organizatat anëtare të RrGGK-së, përfituese të granteve të Raundit të tetë të Fondit të Grave të Kosovës (FGK), raund i cili mbështetet financiarisht nga ADA (18,084.00 €) dhe Zyra e BE-së në Kosovë (31,651.50 €).

Organizatat anëtare të RrGGK-së, përfituese të granteve të Fondit të Grave të Kosovës (FGK) janë:

Grante Avokimi në Partnership për Ndryshim:

- OJQ Legjenda & Qendra Për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve "Liria" Gjilan (artneritet); Iniciativa: "Ngritja e pozitës së gruas në proceset e paqe-bërjes dhe Buxhetimi Gjinator" (7,780.00 €).
- Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes (SHEPF) & OJQ Gruaja Hyjnore; Iniciativa: "Një femër e edukuar – shoqëri e shëndosh" (7,190.00 €).
- Partners Kosova & OJQ Aureola; Iniciativa "Avokimi i grave për të drejtat e tyre pronësore dhe ato të trashëgimisë" (7,604.00 €).
- Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës (OPDMK) & Shoqata Femra Vizionare e Shekullit XXI; Iniciativa: "Përmirësimi i pozitës së grave që përkujdesen për anëtarët me aftësi të kufizuara të familjes" (7,827.50 €).
- OJQ Shqiponjat e Dardanës & OJQ Dritarja; Iniciativa "Avokim për fuqizim të grave fermere në fshatrat e Lipjanit dhe Graçanicës" (7,492.00 €).

Grant Avokimi Individual për një Organizatë:

- Shoqata "Nas Dom"; Iniciativa: "Përfshirja e planifikimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator në nivel lokal" (2,936.00 €).
- Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave; Iniciativa: "Vetëdijësimi i grave dhe vajzave për të drejtat e tyre në kujdesin shëndetësor" (2,988.00 €).
- OJQ Prehja; Iniciativa: "Së bashku kundër dhunës në familje" (2,938.00 €).
- Qendra për Mirëqenien e Gruas; Iniciativa: "Së bashku kundër dhunës në familje" (2,980.00 €)

Personat që do të mbajnë fjalime në këtë konferencë për shtyp janë: Igballe Rogova, Drejtore Ekzekutive e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës; Christian Geosits, Udhëheqës i Zyrës së Austrian Development Agency në Kosovë; dhe Libor Chlad, Zv. Shef i Sektorit për Bashkëpunim, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Fondi i Grave të Kosovës (FGK) i RrGGK-së, i themeluar në vitin 2012, ofron grante të vogla për organizatat e grave që nuk kanë qasje në burime të tjera të financimit dhe të cilat kërkojnë të punojnë për të drejtat e grave, veçanërisht në mesin e grupeve nga vendet rurale dhe/apo grupeve të marginalizuara. Deri më tani, FGK ka përkrahur 74 organizata anëtare të RrGGK-së, me një shumë totale prej 230,691.95 €, ku kanë përfituar rreth 6656 persona. Në vitin 2015, Fondi i Grave të Kosovës po mbështetet nga Austrian Development Agency dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

PRISHTINA

www.womensnetwork.org • Rr. Hajrullah Abdullahu Nr 25 10000
Prishtinë, Kosovë • +381 (0) 38 245 850 •
info@womensnetwork.org